

VENDIM
Nr. 228, datë 21.3.2017

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 3, e 18, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në nënndarjen “Lista e individëve të shpallur sipas procedurës së brendshme të shpalljes”, shtohen individët në përputhje me listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zbatimi i këtij vendimi bëhet nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSO-NAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

LISTA E INDIVIDËVE TË SHPALLUR SIPAS PROCEDURËS SË BRENDSHME TË
SHPALLJES

1. ALDO KOBUZI, i biri i Alfred dhe i Donika, i datëlindjes 17.7.1991;
2. MARIA GIULIA SERGIO (bashkëshorte e Aldo Kobuzi), e datëlindjes 23.9.1987;
3. SERJOLA KOBUZI e bija e Alfred dhe e Donika, e datëlindjes 25.2.1996;
4. DONIKA ÇOKU (KOBUZI) e bija e Hetem dhe e Fiqirete, e datëlindjes 16.5.1971;
5. BAKI ÇOKU i biri i Hetem dhe i Fiqirete, i datëlindjes 19.9.1975.